

II - PROCESI I VLERESIMIT DHE AKREDITIMIT

A - Vlerësimi i Jashtëm

1. Të gjitha Institucionet Publike dhe Private të Arsimit të Lartë duhet t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit periodik institucional. Ky proces kryhet çdo 6 vjet.
2. IAL private, pasi kanë marrë lejen për hapjen dhe fillimin e veprimtarisë, duhet ti nënshtrohen procesit të vlerësimit të parë për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, përpara lëshimit të diplomave për ato programe studimi.
3. Programet e reja në IAL publike dhe private, përpara hapjes, i nënshtrohen procesit të vlerësimit paraprak. Kur këto marrin miratimin për hapjen, duhet ti nënshtrohen procesit të akreditimit, përpara lëshimit të diplomave të para sipas kohëzgjatjes së kursit të plotë të studimit.
4. Procedura e vlerësimit dhe akreditimit fillon kur vetë Institucioni i Arsimit të Lartë Publik ose Privat e kërkon këtë. Kur IAL nuk bën kërkesë sipas afateve ligjore, Agjencia Publike e Akreditimit i bën të ditur institucionit fillimin e këtij procesi, sipas një kalendari vjetor vlerësimesh i cili bëhet publik brenda vitit paraardhës.
5. Procesi i vlerësimit duhet të përbëhet nga Vlerësimi i Brendshëm dhe Vlerësimi i Jashtëm dhe duhet të dokumentohet me një Dosje Vlerësimi.
 - a) Vlerësimi i Brendshëm kryhet nga vetë institucioni i Arsimit të Lartë dhe shërben si bazë edhe për vlerësimin e jashtëm. Procesi i vetvlerësimit duhet të pasqyrojë gjendjen reale të institucionit/programit, të përfshijë gjerësisht komunitetin akademik dhe studentët dhe të kryhet në mënyrë transparente.
 - b) Vlerësimi i Jashtëm kryhet nga Komisioni Ekspertësh të pavarur, vendas, të huaj ose me komisione të përbashkëta. Në këto komisione merr pjesë edhe një student.
 - c) Procedura e Vlerësimit parashikon, përveç shqyrtimit të dokumentacionit, një vizitë në institucion të komisionit të vlerësimit.
 - d) Dosja e Vlerësimit duhet të përmbajë raportet e grupeve të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm, dokumentacionin institucional ku është mbështetur vlerësimi si dhe evidenca të marrjes së opinionit të stafit të IAL, studentëve dhe aktorëve të tjerë.
 - e) Në rastin e vlerësimit paraprak për hapjen e programeve të reja, shqyrtimi bëhet vetëm mbi bazë dokumentacioni.

B - Akreditimi

1. Çdo institucion, njësi kryesore e AL apo program i ri studimi i arsimit të lartë i nënshtrohet akreditimit të parë. Për një program, kurs studimi apo institucion publik ose privat të

licensuar, kërkesa për akreditimin e parë duhet të bëhet brenda periudhës së kursit të plotë të studimit, duke parashikuar dhe kohën e nevojshme për procesin e vlerësimit dhe akreditimit. Vetëm pas një vendimi pozitiv akreditimi, diploma dhe institucioni njihen zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.

2. Për Institucionet e Arsimit të Lartë privat që kanë paraqitur kërkesën për licensim apo hapje të një programi të ri studimi, është i detyrueshëm vlerësimi paraprak i programeve të studimit.
3. Institucionet Private të Arsimit të Lartë që zotërojnë një formë akreditimi nga një shtet tjetër, e paraqesin atë në KA. APAAL dhe KA, në bashkëpunim me institucionet që kanë kryer vlerësimin dhe akreditimin japin vlerësimin e vet për njohjen ose jo të këtij akreditimi.
4. Për vlerësimin dhe akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë publike dhe private që ofrojnë diploma dhe kurse të përbashkëta studimi me IAL të tjera vendase dhe/ose të huaja merret në konsideratë edhe akreditimi i institucioneve partnere si dhe standardet e kriteret e përcaktuara në dokumentat ndërkombëtare për këtë lloj arsimit.
5. Për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të Arsimit të Lartë privat që funksionojnë si filiale të IAL të huaja në Shqipëri, shqyrtimi bëhet rast pas rasti, duke marrë parasysh edhe vlerësimin dhe/ose akreditimin në vendin e origjinës.
6. Kur rezultati i një vlerësimi është pozitiv, pra kur konstatohet përmbushja e standardeve dhe kriterëve përkatëse institucionale apo të programeve, Këshilli i Akreditimit i rekomandon MASH, "Akreditimin pozitiv" të Institucionit/programit të vlerësuar. KA paraqet rekomandimin "Nuk Akreditohet" kur konstatohet një nivel i cilësisë larg standardeve për t'u plotësuar në raport me mundësitë e kapacitetet e institucionit për ti përmbushur ato në një kohë të shkurtër. KA rekomandon "Akreditimin me Kusht" kur nga vlerësimi gjykohet se me kapacitetet dhe mundësitë që ka institucioni, brenda një kohe relativisht të shkurtër, mund të plotësojë standardet e kërkuara.

C - Kohëzgjatja e vlerësimit/akreditimit

1. Një proces i plotë vlerësimi dhe akreditimi mund të zgjasë nga 3 muaj deri në 2 vjet nga fillimi i procesit.
2. Afatet kohore të vlerësimit dhe/ose akreditimit varen nga lloji i vlerësimit, (institucional, programi ose i përbashkët), nga madhësia e institucionit e vlerësuar sipas numrit të njësisve kryesore ose bazë nga të cilat përbëhet, nga numri i programeve të studimit që janë objekt i vlerësimit si dhe ciklit të studimeve që këto të fundit i përkasin.
3. Me përfundimin e një vlerësimi, APAAL paraqet raportin e vlerësimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij Këshillit të Akreditimit. Ky i fundit, brenda një muaji duhet ta shqyrtojë atë dhe të paraqesë rekomandimet përkatëse në MASH.
4. Afati për shqyrtimin dhe njohjen nga KA, e një vendimi akreditimi të marrë nga një shtet tjetër, është jo më shumë se 3 muaj.

D - Publikimi i rezultateve

1. Rezultatet e vlerësimeve periodike, të vlerësimeve analitike dhe raportet përkatëse, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me vlerësimin e cilësisë bëhen publike përmes faqes zyrtare të APAAL.
2. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit publikohen në faqen e APAAL brenda dy javëve pas dërgimit të tyre në MASH.
3. APAAL dhe KA hartojnë një vjetar të aktivitetit të tyre dhe e bëjnë atë publik brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.
4. APAAL, bën publike listën e programeve/institucioneve të akredituara publike dhe private brenda muajit qershor të çdo viti.

E - Procedura e pas-vlerësimit (Follow-up)

1. Në rastin e marrjes së vendimit Akreditim me Kusht, APAAL harton një plan vazhdimësie për përmbushjen e kërkesave brenda afatit të vendosur nga KA dhe ndjek zbatimin e tij në vazhdimësi.
2. Pas kësaj periudhe kohore, në bazë të vlerësimit të kryer nga Agjencia, Këshilli merr vendimin përfundimtar.

F - E drejta e ankimit

1. Institucionet e Arsimit të Lartë kanë të drejtë të ankohen pranë APAAL për përmbajtjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Çdo ankimim duhet të shoqërohet me të dhëna e argumenta që mbështesin ankimin apo vërejtjet përkatëse. Komisioni i Vlerësimit mund të marrë parasysh vërejtjet kur ato janë të mbështetura në argumenta e prova konkrete dhe ti reflektojnë ato në raportin përfundimtar.
2. IAL mund të ankohen pranë KA për procedurën e vlerësimit, duke paraqitur prova e argumenta të qarta në mbështetje të ankimit. KA ngre Komisionin e Ankimit posaçërisht për këtë qëllim.



AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

Bulevardi "Zhan D'Ark", Pallatet e Lanës, Nr.2, Ap.17, Tiranë
Tel/Fax: +355 4 2257 954 / +355 4 2266 302
E-mail: aaal@almail.com / Website: www.aaal.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES



AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

DHJETOR 2007

I - INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË

1. Sistemi i Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit në Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë ka për funksion organizimin dhe kryerjen e procesit të vlerësimit dhe akreditimit në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik dhe Privat përmes vlerësimit dhe akreditimit.
2. Sistemi i Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga Sistemi i Sigurimit të Brendshëm dhe Sistemi i Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë.
3. IAL janë përgjegjëse për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me Institucionet e Sigurimit të Jashtëm.
4. Institucionet e Sistemit të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë janë Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), me Këshillin e Akreditimit (KA), në bashkëpunim me Këshillin për Arsimin e Lartë dhe Shkencën (KALSh), Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Këshillin e Ministrave (KM).

A - Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL)

1. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është institucion qendror, publik, buxhetor, përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm të cilësisë në Arsimin e Lartë publik dhe privat. Këtë funksion APAAL e kryen në përputhje me kriteret e procedurat shtetërore si dhe me standardet europiane e ndërkombëtare.
2. Në kryerjen dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit APAAL gëzon pavarësi operative në lidhje me procedurat e vlerësimit, përmbajtjen e raporteve e rezultateve të vlerësimit, bashkëpunimin me Këshillin e Akreditimit dhe IAL si dhe në publikimin e informacionit që lidhet me vlerësimin dhe akreditimin; në këtë proces, APAAL dhe KA mbështeten edhe në standardet europiane për pavarësinë operative të Institucioneve të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë (SESCAL).
3. Struktura dhe Organika e APAAL përbëhet nga: Drejtori, Sektori i Vlerësimit dhe Analizave, Sektori i Informacionit dhe Publikimit dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse. Në strukturën e APAAL bën pjesë dhe Sekretariati i Këshillit të Akreditimit.

Fusha e veprimtarisë e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë

APAAL është përgjegjëse për procesin e vlerësimit të programeve të studimit dhe institucioneve në Arsimin e Lartë Publik dhe privat.

1.Për kryerjen e këtij funksioni, APAAL zhvillon këto veprimtari kryesore:

- a) Pranon dhe regjistron kërkesat e IAL-ve për vlerësim dhe akreditim;
- b) Përgatit kalendarin e vlerësimeve vjetore dhe ja paraqet atë që në fillim të vitit për miratim KA; ky kalendar bëhet publik për të gjitha IAL publike dhe private;
- c) Ndjek dhe monitoron të gjithë procesin dhe procedurat për vlerësimin paraprak, të parë dhe

periodik të cilësisë, për të gjitha programet e studimit e institucionet publike e private, të reja dhe ekzistuese të arsimit të lartë;

- d) Përgatit të gjithë dokumentacionin e vlerësimit, të shoqëruar me një raport mbi zhvillimin e të gjithë procesit sipas procedurave përkatëse dhe ja paraqet këtë për shqyrtim Këshillit të Akreditimit;
- e) Harton kriteret për vlerësimin e cilësisë për programet dhe institucionet e arsimit të lartë, të reja dhe ekzistuese, udhëzues për vlerësimin dhe akreditimin, procedurat e vlerësimit si dhe dokumente të tjera që rregullojnë e disiplojnë këtë proces dhe ja paraqet këto për miratim Këshillit të Akreditimit. Agjencia ka detyrimin që t'ua bëjë të njohura paraprakisht standardet, kriteret, kërkesat e procedurat e vlerësimit e akreditimit, të gjitha institucioneve të arsimit të lartë;
- f) Bashkëpunon ngushtë me Këshillin e Akreditimit për lidhjen e vlerësimit të jashtëm me akreditimin dhe njëkohësisht mbështet me sekretariat teknik, buxhet dhe logjistikë Këshillin e Akreditimit.
- g) Bashkëpunon me KALSh për hartimin e standardeve shtetërore të cilësisë, përpara miratimit nga MASH;
- h) Harton, në bashkëpunim me KA, në fund të çdo viti një raport të veprimtarisë së saj, i cili bëhet publik brenda 4 muajve të parë të vitit pasardhës.

APAAL kryen dhe detyra të tjera:

- i) Kryen vlerësime paralele për programet dhe për institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat;
- j) Bashkëpunon me IAL publike dhe private për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të tyre të brendshme të sigurimit të cilësisë;
- k) Kryen edhe vlerësime krahasuese e harton raporte analitike të sistemit të arsimit të lartë sipas një ose disa aspekteve e treguesve. Mbështetur në kriteret të qarta, mbi të dhëna të sakta e të besueshme dhe në rezultatet e vlerësimit, APAAL në bashkëpunim me KA, mund të kryejë e shpallë renditjen e IAL ose diplomave të ngjashme në përputhje me këto rezultate.
- l) Jep informacion publik të përditësuar mbi statusin e IAL-/programeve lidhur me vlerësimin dhe akreditimin si dhe bën të njohur, para fillimit të çdo viti akademik listën e programeve të studimit dhe institucioneve të arsimit të lartë të akredituar.

B – Këshilli i Akreditimit (KA)

1. Këshilli i Akreditimit është një organ kolegjal pranë APAAL dhe funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi për këto organe.
2. Këshilli i Akreditimit, mbështetur dhe në koherencë me të dhënat dhe rezultatet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë,

rekomandon hapjen e programeve të reja dhe akreditimin e programeve/institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat.

3. KA është i pavarur në punën e tij dhe bën publik vendimet duke shprehur dhe mendimet kundër.
4. Në Këshillin e Akreditimit përfaqësohen në mënyrë të balancuar Institucionet e Arsimit të Lartë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, ekspertë të fushave si dhe një student nga organizimet studentore.
5. Mandati i antarëve të KA është 5 vjet. Antarësia në KA është e papajtueshme me detyrën e rektorit, zv/rektorit e dekanit.

Fusha e veprimtarisë së Këshillit të Akreditimit

1. Veprimtaritë kryesore të Këshillit të Akreditimit janë:

- a) shqyrton dhe miraton kriteret, procedurat dhe dokumentat kryesore të përgjithshme dhe të veçanta për vlerësimin dhe akreditimin e programeve dhe institucioneve të arsimit të lartë, të hartuara nga Agjencia e Akreditimit;
- b) miraton kërkesat e Institucioneve të Arsimit të Lartë për vlerësim si dhe periudhën gjatë së cilës duhet kryer vlerësimi;
- c) miraton, në bashkëpunim me APAAL, kalendarin vjetor dhe afatgjatë të vlerësimeve;
- d) shqyrton dhe miraton përbërjen e grupeve të ekspertëve të jashtëm, që propozohen nga APAAL, pas përzgjedhjes së tyre sipas kriterëve të paracaktuara;
- e) vendos për rezultatin përfundimtar të një vlerësimi të kryer nën drejtimin e APAAL; për këtë KA mbështetet në raportin e vlerësimit të jashtëm dhe harton rekomandimet përkatëse të akreditimit, përkundrejt kriterëve dhe standardeve të cilësisë në Arsimin e Lartë ose praktikën më të mirë, në rast të mungesës së standardeve të fushës. Kur vlerësimi është kryer nga një agjenci tjetër që operon sipas pikës III.3, KA, pasi shqyrton nëse ky vlerësim është kryer në përputhje me standardet, kriteret, kërkesat e procedurat në fuqi, mbështetur tek ky i fundit, harton rekomandimet përkatëse. Kur një vlerësim është kryer nga një agjenci e huaj që nuk operon sipas pikës III.3, KA i kërkon APAAL të shqyrtojë këtë vlerësim në bashkëpunim me agjencinë e huaj që ka kryer vlerësimin; kur vlerësimi është kryer në përputhje me standardet, kriteret, kërkesat e procedurat në fuqi, KA e merr në shqyrtim dhe harton rekomandimet përkatëse për MASH; në rast të kundërt vlerësimi konsiderohet i pavlefshëm.
- f) Mbështetur në vlerësime paraprake, KA rekomandon hapjen ose jo të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe/ose programeve të reja të studimit;

- g) Mbështetur në rezultatet e vlerësimit, KA harton rekomandimet për llojin dhe natyrën e vendimin të akreditimit: akreditim pozitiv, akreditim negativ ose akreditim me kusht.
- h) Shpall vendimin e akreditimit, në rastet kur MASH nuk merr vendim për akreditim brenda një muaji nga paraqitja e rekomandimeve nga KA.
- i) Në rastet kur një IAL apo filial i tij në Shqipëri, ka një formë akreditimi nga një shtet tjetër, KA, pasi i kërkon APAAL verifikimin formal të këtij vendimi, e merr atë në shqyrtim dhe, kur vlerëson se ky është marrë në përputhje me standardet, kriteret, kërkesat e procedurat shtetërore në fuqi, e konsideron të vlefshëm dhe njofton për këtë MASH.

C - BASHKËPUNIMI ME TË TJERË

Për realizimin e veprimtarisë së tyre, APAAL dhe KA bashkëpunojnë ngushtë me organizma homologe vendase dhe të huaja si dhe me ekspertë e konsulentë vendas e të huaj të fushave të Arsimit të Lartë.

APAAL dhe KA bashkëpunojnë me:

- a) Institucione homologe europiane dhe ndërkombëtare, me Rrjetet Ndërkombëtare të Agjencive për antarësimin në këto rrjete, për realizimin e vlerësimeve të përbashkëta, për shkëmbim eksperience, përgatitjen e marrëveshjeve për njohje reciproke të vlerësimit e akreditimit, etj.
- b) IAL për marrjen e të dhënave, ngritjen e Sistemeve të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, në përputhje me kriteret e standardet shtetërore dhe ato europiane e ndërkombëtare;
- c) Organizata Profesionale, Institucione Shtetërore e Private që lidhen me Tregun e Punës për këmbim informacioni, ekspertize, dhe me Institucione të tjera që lidhen me Arsimin e Lartë.
- d) Organizatat e ligjshme studentore si dhe përfaqësues të komunitetit studentor për informimin dhe përfishirjen e tyre në procesin e Vlerësimit dhe akreditimit.

- Në kryerjen e detyrave e funksioneve të tyre dhe për të ndihmuar procesin e vlerësimit, vendimmarrjen dhe hartimin mbi baza profesionale të vlerësimeve dhe hartimin e rekomandimeve përkatëse, APAAL dhe KA bashkëpunojnë gjerësisht me ekspertë e konsulentë të jashtëm, vendas dhe/ose të huaj.
- APAAL dhe Këshilli i Akreditimit ngrenë Komisionet Ekspertësh për Vlerësimin e Jashtëm, sipas fushave kryesore të Arsimit të Lartë, si dhe përcaktojnë e zbatojnë kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e tyre. Në këto komisione duhet të marrë pjesë edhe 1 student.